

0801-93

Vihb. Dp.

1/12

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

Aktivitete projektuese
në arsimin e mesëm- në gjimnazin e reformuar



LËMIA
KLUBET LETRARE DHE SEKSIONET DRAMATIKE

Bllaga PANEVA

Shkup, 2004

Aktivitete projektuese në
arsimimin gjimnazor

KLUBE TË LETËRSISË DHE SEKSIONE DRAMATIKE

Dramë

Debat

Literaturë-art

poezi

reportazhë

prozë

Gazetë shkollore

GAZETARI

1. TITULLI I AKTIVITETIT PROJEKTUES

Aktiviteti projektues nga lëmia Klubet letrare dhe sektionet dramatike i përfshijnë këto lëmi:

klubi letrar

drama dhe seksioni dramatik

klubi debativ

gazeta shkollore

2. NEVOJITET:

Aktivitetet projektuese janë lëmi në vete në Planin mësimor funksioni i së cilës është përbushja e intereseve individuale dhe dëshirave të nxënësve në lëmi të caktuara. Ato dallohen nga lëndët mësimore dhe realizohen në këtë mënyrë:

- * sipas zgjedhjes së lirë të nxënësit;
- * në kuadër të fondit vjetor të orëve;
- * viti mësimor prej vitit I- IV;
- * në shkollë dhe jashtë saj;
- * 35 orë¹
- * fondi²

- klubi letrar 35 orë;
- drama dhe seksioni dramatik 35 orë;
- klub debativ 35 orë;
- gazeta shkollore 35 orë;

3. QËLLIMI I AKTIVITETIT PROJEKTUES

3.1. Qëllimi i përgjithshëm

- Vendosja e nxënësve në punën hulumtuese;
- aftësimi i nxënësve për punë të pavarur;
- zbulimi i afilitetit te nxënësit;
- bashkëpunim mes grupeve (punë ekipore)
- nxitja e aftësive individuale;
- respektimi i vendimeve që sjellen në kuadër të grupeve

¹ Në vitin e IV vëllimi i aktiviteteve projektuese arrin 30 orë ose gjithsej 60 orë në vit.

² Për hyrje të projektit në vitin e I përdoren 15 orë, që arsimtar i shfrytëzon për dhënë të drejtimeve të përgjithshme dhe sqarimin e qëllimit, metodologjisë hartimit të planit për punë, analizë e të dhënave, hartimi i hulumtimit, instrumente për hartimin e detyrave projektuese dhe mënyra e prezentimit të tyre. 20 orët tjera të mbeturë i shfrytëzojnë për hartimin e detyrës projektuese dhe për prezentimin e projektit, nën mentorimin e arsimtarit.

- zgjerimi dhe thellimi i njohurive të nxënësit;
- marëdhënie aktive me nxënësin;
- përkrahje nga shkolla për plotësimin e procesit që duhet të realizohet;
- shfrytëzimi efektiv i kapaciteteve në shkollë dhe institucionë tjera;
- realizim kreativ;
- paraqitja e punimeve të nxënësve para opinionit më të gjërë (psh. aktivitetet dramatike mund të shfaqen gjatë patronatit të shkollës, në teatrin alternativ FAAT ose në manifestime tjera kulturore).

3.2. Qëllimet konkrete:

- Përgatitja e nxënësve (15 orët e para) për hartimin e detyrës projektuese në funksion të përgatitjes për përpunim të suksesshëm të detyrës së maturës;
- zbulimi i interesimit të nxënësve për literaturën dhe artin;
- zgjerimi dhe thellimi i njohurive të nxënësit për letërsi, dramë, debatet dhe gazetarinë;
- nxitja e shprehjes kreative (në të shkruarit dhe në aktrim);
- bashkëpunim me anëtarët tjerë të ekipit;
- paraqitje e suksesshme të projekteve të përpunuara, lidhshmëri me projekte (nga lëmitë tjera) dhe prezentim të bujshëm para opinionit.

4. AKTIVITETE PROJEKTUESE SIPAS LËMIVE DHE TEMAVE

KLUBI LETRAR

Aktivitetet mund të orientohen në shumë sfera.

Në plan të parë qëndron aftësia kreative e nxënësve kështu që do të lexohen përbërjet letrare të anëtarëve, e më pas do të diskutohet për vlerat e pjesës së lexuar. Mund të lexohen edhe përmbajtje që kanë të bëjnë me jetën dhe veprën e shkrimtarit me çraست do të shfrytëzohet edhe bisedë me shkrimtarë nga vendi ku jetojnë nxënësit. Suksesi i ndonjë vepre mund të paraqitet edhe përmes leximit të fragmenteve dhe komente nga e njejtë. Në këtë kahje mund të shfrytëzohet edhe ushtrimi i nxënësve për lexim dhe recitim të bukur estetik. Puna mund të orientohet edhe duke grumbulluar tregime popullore (nga interpretatorë të gjallë ose nga institucionet) dhe shqyrtimi i përmbajtjes dhe rekomandimeve që i ofrojnë ato. Mund të përfshihen më shumë tema, por pa ndonjë radhitje të caktuar.

Problema ndoshta do të paraqesin animi në punë, përkufizimi i kohës ose përpuehshmëria me disa aktivitete tjera dhe mungesa e kohës e nevojshme për temën që hartohet.

Koha e shfrytëzuar sipas rregullave duhet të bazohet në:

- 1. orarin e aktiviteteve punuese;*
- 2. temat që duhet hartuar;*
- 3. numri i orëve për përmbajtjet konkrete:* (psh. sa orë nevojiten për të lexuar përbërjen e anëtarëve, për shkrimtarët dhe veprat e tyre, takimet me arsimtarët, rezultatet nga materiali i grumbulluar etj)

Në qoftë se e gjithë kjo merret parasysh atëherë me sukses mund të planifikohet puna vjetore dhe me sukses të realizohen detyrat e parashtruara.

E rëndësishme është që të caktohet edhe koha (dita, vendi dhe ora) me çka te nxënësit formohet shprehia për përgjegjësi, plotësueshmëri dhe saktësi.

Përbajtjet dhe propozim temat³

N.ren.	Përbajtjet	Propozim temat:
I	Normat e drejtshkrimit	<ol style="list-style-type: none"> Drejtshqiptimi- hulumtimi për(jo)të folurit e drejtë Theksi- hulumtim i shfrytëzimit të rregullt dhe (jo) të rregullt të mjeteve prozodike
II	Të folurit letrar	<ol style="list-style-type: none"> Shprehje emocionuese Pushim,intonacion Zbatimi i theksit
III	Teoria e letërsisë	<ol style="list-style-type: none"> Stilistikë-lloji i stileve dhe përdorimi i tyre Zgjedhja e tekstit të literaturës dhe komentimi i stilit Folklori- elementet etnologjike në letërsi Analiza e veprës nga letërsia popullore Poezia - zhvillimi gjatë shekujve Kahje për të shkruar tekst poetik Prozë - zhvillimi gjatë historisë Të shkruarit e tekstit në prozë
IV	Humanizmi dhe renesansa	<ol style="list-style-type: none"> Përfaqësues të renesansës italiane dhe evropjane-karakteristike të tekstit Lexim tekstesh nga veprimtaria arsimore në R. Maqedonisë dhe diskutim për të njëjtat Të
V	Krijimtaria popullore	<ol style="list-style-type: none"> Epika- tekst sipas krijimtarisë popullore Baladat në krijimtarinë popullore Përpjekje për të shkruar balada Diskutim për baladën e shkruar Romanet në krijimtarinë popullore Përpjekje për të shkuar roman Diskutim për romanin e shkruar Përpjekje për përbërjet letrare Pjesëmarrje në konkurs

³ Nga lista e përbajtjeve të ofruara nxënësi mund të zgjedh, por mund të ofrojë edhe titullin e vet për projektin që dëshiron ta realizojë.

VI	Romantizmi	1. Karakteristikat në drejtimin letrar përmes veprës së zgjedhur nga romantizmi evropjan 2. Jeta dhe vepra e përpunuar të romantizmit evropjan
VII	Krijimtaria popullore shqiptare	Kënët popullore: (epike,lirike dhe dramatike)
VIII	Realizmi	1. Realizmi botëror- elementet që gjenden në tekstin letrar 2. Përpjekje për të shkruar tregim realist 3. Diskutim për përbajtjen e tregimit realist
IX	Letërsia shqiptare	1. Drama mes dy luftërave botërore 2. Përpjekje për të shënuar tekst dramatik sipas motivit të dhënë 3. Diskutim për tekstin dramatik të shkruar 4. Hulumtimi në temën „Cili është romani i parë shqiptar?“
X	Realizmi, modernizmi	1. Tregime sipas zgjedhjes së realistëve botërorë të shek '20 2. Përpjekje për të shkruar tregim realistik 3. Diskutim për përbajtjen e shkruar 4. Të shkruarit e këngës lirike të inspiruar nga modernizmi 5. Diskutim për këngën e shkruar
XI	Letërsia bashkëkohore shqiptare	1. Romani bashkëkohor shqiptar 2. Takim me romansier shqiptar 3. Poezia bashkëkohore shqiptare 4. Takim me poet shqiptar të pas luftës 5. Përpjekje letrare-për të shkruajtur poezi 6. Drama bashkëkohore shqiptare 7. Takim me dramaturg shqiptar 8. Përpjekje për kritikat letrare

DRAMA DHE SEKSIONI DRAMATIK

Orientimi themelor nga kjo lëmi ka të bëjë me formimin e seksionit dramatik dhe përcaktimin e nxënësve që posedojnë afinitetë dhe interes për dramën dhe artin dramatik. Duke pasur parasysh specifikën e kësaj lëmie duhet të patur kujdes gjatë selektimit të nxënësve, të zgjedhen nxënës që do ta pranojnë tempon e pëershpejtuar të përgatitjeve të shfaqjeve dramatike, por edhe nxënës që do të hulumtojnë interes nga lëmi i artit teatral. Është e nevojshme që të nxitet kreativiteti dhe puna individuale dhe tematike.

Pavarsisht nga numri i nxënësve dhe nga mundësitetë tjera, arsimtari duhet ta organizojë punën me nxënësit duke formuar grupe që do të realizojnë nëntema në projekt, kurse kanë të bëjnë me artin dramatik. Për këtë aktivitet e dëshirueshme është që nxënësit të bashkëpunojnë me institucione nga kultura (para së gjithash me teatrin) dhe personë të inkuadruar në këto institucionë.

Realizimi do të jetë i suksesshëm vetëm atëherë nëse aktivitetet definohen në hollësi dhe qartë dhe nëse përcaktohet dinamika e tyre.

Propozim temat⁴

Nr.ren	Temat:
1	Nocioni për teatrin
2	Teatri si art
3	Lidhshmëria e teatrit me letërsinë
4	Vizita në teatër dhe mbikëqyrja e lokaleve
5	Karakteristikat e shfaqjes teatrale
6	Prania e shfaqjes teatrale dhe ruajtja e të folurit teatral
7	Prania e shfaqjes teatrale dhe ruajtja e tingujve të muzikës dhe tingujve tjerë
8	Dekorimi në shfaqjen teatrale
9	Skenografia si element i rëndësishëm
10	Roli i kostumeve në shfaqje teatrale
11	Roli i aktorit në shfaqje teatrale
12	Vendosja e tekstit (Sipas zgjedhjes) për paraqitje dramatike
13	Bashkëpunim me aktor nga teatri
14	Bashkëpunim me regjisori të teatrit
15	Ushtrime në role dramatike
16	Ushtrime në dialoge ose monologe
17	Rrjedha e veprës dramatike
18	Situata ku gjendet personazhi dramatik
19	Lëvizja në skenë në funksion të shfaqjes teatrale
20	Toka Jonë- Kolë Jakova
21	Elementet e gjuhës dramatike: (koha, vepra, situata, etj.)
22	Vendosja e tekstit dramatik për paraqitje në skenë (sipas zgjedhjes individuale)
23	Koha në shfaqjen teatrale
24	Veprimi në shfaqjen teatrale
25	Vendi në shfaqjen teatrale
26	Vizitë në shfaqjen teatrale
27	Përpjekje për tu bërë paralele midis tekstit dramatik dhe shfaqjes teatrale
28	Provë e tekstit për shfaqje teatrale
29	Leximi sipas roleve
30	Lëvizja në skenë
31	Vendosja e mizanskenës
32	Trumbullakësimi i ciklusit të dramës dhe shfaqjes teatrale
33	
34	Përgatitje për rimejk të shfaqjes' Halili dhe Hajria:
35	Vizitë në shfaqje teatrale (sipas mundësive të ofruara)
36	Diskutim lidhur me shfaqjen e vizituar
37	Kritik dramatik
38	Përgatitja e tekstit për tu paraqitur në skenë

⁴ Nga lista e temave ofruese, nxënësi mund të zgjedh, por mund të ofrojë edhe titullin e vet për projektin që dëshiron ta realizojë.

39	Leximi i roleve
40	Ushtime në skenë
41	Shuma e rezultateve

KLUBI DEBATIV

Aftësia për shprehje gojore nënkuption t njohja e mirë e gramatikës dhe fjalorit të një gjuhe. Planpogramet mësimore në shkollë shpeshherë eparaqesin zhvillimin e qartë të folurit, si rezultat e të folurit në opinion, vetëm atëherë kur bëhet fjalë për përononjë temë kontaversale, që për disa paraqet stres. Me këtë rast disa njerëz shumë rëndë e tregojnë qëndrimin e tyre, kurse të tjerët dinë të janë sulmues dhe të mos i respektojnë qëndrimet e të tjerëve. Për aftësinë të flitet në mënyrë të suksesshme dhe të diskutohet për temë të caktuar që nënkuption zotërim i shkathtësive linguistike, intelektuale dhe sociale.

Debati paraqet suazë për zhvillimin e diskutimeve të strukturuara në tema të ndryshme. Dy ekipe i paraqesin argumentet dhe kontraargumentet e tyre me qëllim që t'i bindin gjyqtarët në drejtësinë e qëndrimeve të veta me ndihmën e aftësive retorike.

Debatet ndihmojnë në zhvillimin e:

- * Mënyra logjike dhe kritike e të menduarit;
- * shkathtësitë për organizimin e mendimeve individuale;
- * të shprehurit gojor;
- * empatia dhe toleranca e qëndrimeve, që janë më ndryshe nga tonat;
- * vetëbesimi;
- * aftësia të punohet vetëm në një ekip;
- * me aftësi të koncentrohemë në esencën e pyetjes;
- * mënyra e qëndrimit gjatë paraqitjes publike;

Këto janë shkathtësi, të cilat janë të domosdoshme për komunikim të suksesshëm me të tjerët. Shkathtësia e vetme e cila është e domosdoshme gjatë negociatave në jetën reale, e cila nuk ushtronhet me debatet është shkathtësia që të vihet deri te kompromisi. Por, duke përgatitur debatin pjesëmarrësit patjetër do të duhej që në detaje ta analizojnë tempën e dhënë, domosdo do t'i masin interpretimet dhe implikimet e ndryshme të së nejtas temë. Kjo dmth se në mënyrë indirekte me këtë bëhemë më të hapur drejtë zgjidhjeve kompromise.

Debati më së shumti kontribuon për zhvillimin e mënyrës kritike në të menduarit dhe i përgatitë nxënësit:

- * të sillen në mënyrë intelegrante dhe të marrin pjesë në shoqërinë ku jetojnë;
- * të votojnë dhe të mund të gjenden në rol të liderit;
- * të hulumtojnë, të shqyrtojnë dhe të analizojnë probleme të rëndësishme nga përditshmëria e tyre;
- * të mësojnë që të bashkëpunojnë me kolegët e tyre;
- * të mësojnë që të shkruajnë dhe të mbajnë fjalim;
- * të mund të jepin përgjigje të shpejtë analitike;
- * të janë dëgjues kritik;
- * të sjellin vendime të pjekura;
- * të fitojnë vetëbesim dhe ndjenjë sigurie.

Debatet mund të kenë formë të ndryshme. Ato mund të kenë karakter garues, parlamentare ose të jenë pjesë e aktiviteteve të lira të nxënësve.

Përgatitja e nxënësve për debat

Për në fillim mund të punohet vetëm me 6 nxënës, por është më mirë të ketë sa më shumë pjesëmarrës (psh. 12). Në këtë mënyrë do të mundet të ndërrohet përbërja e ekipeve, por edhe nëse ndodh që ndonjë nxënës patjetër të mungojë kjo nuk do të jetë shkaku që debati të shtyhet.


Roli i foltoreve të ndryshme (1,2 ose 3) kërkon karakteristika tjera dhe për këtë disa nxënës pothuajse më së miri mund të gjenden në role të caktuara, por pa marr parasysh këtë çto anëtarë patjetër të merr pjesë në përgatitjet por edhe të provojë çdo folës në vendin, debatin ku ndodhet.

Nxënësit në debatet:

- matës i kohës,
- gjyqtar,
- ekipe

P.sh. në radhitjen e folësve:

A - mbrojtës
B - sulmues



VËREJTJE: A2, B2, A3 dhe B3 mund të jepin dëshmi të reja për shtojcë të tezës, por nuk mund të vendosin argumente të reja.

Kur bëhet fjalë për fillestarë ose për pjesëmarës shumë të rinjë, koha e debatit mund të ndahet (kremtohet) në gjysmë.

Ekipet gjithashtu, kanë të drejtë në 8 minuta konsultim, të cilat mund t'i shfrytëzojnë menjëherë, para ose në fund të debatit ose ta shfrytëzojnë në pjesë më të vogla sipas disave nga bisedat e anëtarëve të ekipit të tyre.

PËRGATITJA

Përgatitja bëhet para debatit. Anëtarët e ekipit punojnë dhe vendosin bashkarisht:

1. në cilën mënyrë do ta formulojnë tezën;
2. cilat aspekte do t'i marrin parasysh

aspektet duhet mirë të hulumtohen që të marrin argumente dhe dëshmi përkatëse. Përveç vjalës në fillim ose hyrjes të A1, i cili mjeshtërisht duhet zbatohet, anëtarët tjerë të ekipit nuk është e domosdoshme t'i shënojnë fjalimet e tyre në tërsësi.

Nga rëndësia tjetër për ekipin negativ është që të përgatisin argumente alternative që të mund në çdo rast të përgjigjen në ekipin afirmativ.

Është e lejueshme që anëtarët e një ekipi të këmbejnë shënimë apo vërejtje me shkrim , por kjo duhet të nxitet në të dy ekipet.

Hapat që rekomandohen


1. "Rëndësia e fjalëve"- vetëdijësim sepse bëhet fjalë për lojë komunikative . (psh. Gjysma e grupit do të shohë një fotografi ku gjysma tjetër nuk do të mund ta shohë. Ata që mund ta shohin fotografinë duhet t'iu diktojnë atyre që nuk e shohin fotografinë, por edhe t'ia vizatojnë fotografinë. Ata të cilët diktojnë nuk duhet të shikojnë se si vizaton partneri i tyre).
 2. Të treguarit e një debati në video;
 3. Nxënësit vetë duhet të nxjerrin konkluzë apo përfundim, e pastaj arsimtari t'iu sqarojë rregullat.
 4. Të analizohen rolet e folësve;
 5. Definicione;
 6. Mënyrat në të cilat mund të zhvillohen argumentet;
 7. Aspektet e gjykimit
-
8. Zhvillimi i teknikave me të cilat mbahet fjalimi (artikulimi, zëri..)
 9. Ushtrime për paraqitje të ndryshme;
-
10. Dhënia e ideve;
 11. Hulumtimi;
 12. Grupimi dhe selektimi i argumenteve;
 13. Të shkruarit e fjalimit;
-
14. Ushtrime e debateve , të cilat paraprakisht duhet të përgatiten;
 15. Ushtrimi i gjykimit;
 16. Ushtrime, ushtrime,ushtrime...
 17. Përgatitja për gara.

Procedurat që gjenden midis linjave të ndërprera janë të lidhura ngushtë dhe duhet të ushtrohen bashkarisht. Të gjitha këto pika duhet vazhdimisht të ushtrohen për arsy që nxënësit të janë më të sigurtë në paraqitjen e tyre dhe t'iu sqarohen ato punë që në fillim nuk i kishin të qarta. Ushtrimi çdoherë duhet të jetë në fokusimin-vatërzimin e punës.

Gazeta shkollore

Gazeta shkollore, në kuadër të aktiviteteve projektuese duhet të funksionojë si informator për të gjitha aktivitetet nga lëmitë , të cilat realizohen në kuadër të Aktiviteteve projektuese. Angazhimi i nxënësve do të rrjedhë nga aktualitetet që ndodhin në mjedisin dhe në shkollë dhe nga realizimi i të gjitha lëmive të aktiviteteve projektuese. Mënyra e organizimit të punës vendoset në bazë të përcjelljes, intervistave, fotografimit, dokumentimit, reportazhave nga hulumtimi i grupeve tjera kurse do të rrumbullakësohen përmes botimit të gazetës së shkollës. Gazeta shkollore duhet të jetë e organizuar sipas rregullave të shtypit ditor dhe të përbajë të gjitha informatat e nevojshme.

5. ORGANIZIMI DHE REALIZIMI I AKTIVITETEVE PROJEKTUESE



Elementet e aktiviteteve projektuese për nxënësit

5.1. Organizimi i kohës

- * Planifikimi gjatë ditëve të punës në javë, por jo si orë në orarin e rregullt
- * koha duhet të jetë e përshtatshme për nxënësit dhe të mos përputhet me orarin e rregullt të orëve;
- * aktivitetet mund të zhvillohen edhe jashtë shkollës varësisht nga nevojat e projektit.

5.2. Organizimi i grupeve projektuese

- * Arsimtar organizon dhe realizon grupe projektuese sipas kapaciteteve në shkollë dhe dëshirave, afiniteteve të nxënësve;

5.3. Rol i arsimtarit

- * t'i planifikojë aktivitetet;
- * t'iu ndihmojë nxënësve në punë;
- * rol mentor;
- * roli i trajnuesit (trajnim për aktivitete konkretuese);
- * ta përcaktojnë kohën atëherë kur të paraqiten aktivitetet përmes orarit të orëve i cili nuk do të përputhet me mësimin e rregullt, por edhe nuk do t'i ngarkojë plotësisht nxënësit;
- * t'i përcaktojnë:
 - detyrat (cila?)
 - afatet (deri kurë?)
 - bashkëpunimin (me cilin?)
- * të formojnë grupe
- * të mbajnë evidencë të aktiviteteve të nxënësve në formularë të përgatitur për këtë qëllim (portfolio).

5.4. Aktivitetet e nxënësve:

- * të zgjedhin aktivitet projektues sipas afiniteteve personale;
- * të posedojnë kontinuitet në punë
- * reciprokisht të bashkëpunojnë
- * vazhdimisht ta përfaqësojnë shkollën në manifestime
- * ta realizojnë aktivitetin projektues të paraparë
- * të bëjnë portfolio individuale, të cilën do ta kontrollojë arsimtar

5.5. Bashkëpunim me:

- * mentorin;
- * arsimtarët tjera;
- * bashkëpunëtorët profesional (pedagogë, psikologë, sociologë, bibliotekistë etj..)
- * bashkëpunëtorë të jashtëm (psh. nga teatri, veprimtaritë botuese, shkrimitarë, gazetarë etj.)
- * nxënës;
- * kujdestari i klasës, i cili do t'i verifikojë dokumentet që kanë të bëjnë me realizimin e aktiviteteve projektuese.